



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.674/2017**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.09.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk dhe “Toni Security” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedure e Hapur*” me Nr. REF-06027 -04- 13-2017 me objekt: “Blerje e shërbimit privat të ruajtjes fizike për Spitalin Rajonal Durrës”, me fond limit 10.006.073 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 19.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.

**Ankimues:**

“NSS” shpk  
Blv.Zogu I”, Ndërtesa 53, kati 3.  
Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Rajonal Durrës  
Lagjia nr.8, Rr.A.Goga, Durrës.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator i ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 14.04.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedure e Hapur*” me Nr. REF-06027-04-13-2017 me objekt: “Blerje e shërbimit privat të ruajtjes fizike për Spitalin Rajonal Durrës”, me fond limit 10.006.073 leke pa tvsh, e zhvilluar në datën 19.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.

II.2. Në datën 19.05.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 16.06.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Kushtrimi 2002

nuk ka paraqitur ofertë

- Eurogjici Security	8.634.436,66 lekë	I skualifikuar
- Hoxha Security	9156584,00 lekë	I skualifikuar
- Vrana Security Group	9165782,82 lekë	I skualifikuar
- NSS	9168863,99 lekë	I skualifikuar
- Nazeri 2000	9999031,68 lekë	I skualifikuar
- Toni Security	10002392,73 lekë	I skualifikuar

II.4. Në datën 16.06.2017 operatori ekonomik “NSS” shpk, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

*“1. Nuk ka paraqitur Vertetim nga Drejtoria E Policise Qarkut per shlyerjen e detyrimeve financiare per vitin 2016 konform ligjit Nr. 75/2014 per sherbimin privat te sigurise fizike si dhe Udhezimit te M.P.B. Nr. 157 date. 01.04.2015 per funksionimin esherbimit privat te sigurise fizike, sipas shtojces se paraqitur ne DST per piken 5.  
2. Mungon dhe formulari i sigurimit te ofertes”.*

II.5. Në datën 20.06.2017 operatori ekonomik “NSS” shpk., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor. Konkretisht ankimesi në ankesën e tij pretendon si më poshtë:

*“Ne daten 16.06.2017 , permes faqes se APP jemi informuar per publikimin e renditjes se Ofertave te Procedures se Prokurimit, Procedure e Hapur me objekt "Blerje e sherbimit privat te ruajtjes fizike per Spitalin Rajonal Durres" me Autoritet Kontraktor " Spitalin Rajonal Durres" me fond limit 10'006'073 (dhjete milion e gjashte mije e shtatedhjete e tre) leke pa TVSH.*

### Public Health Sector

*Shoqeria NSS Ndreu Security Services Shpk eshte nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne fushen e shoqerive private te sigurise fizike dhe si e tille ka marre pjese ne proceduren e prokurimit te mesiperme.*

*Nga renditja e ofertave te Operatoreve Ekonomike publikuar ne faqen e APP dt.16.06.2017 vihet re se oferta jone eshte skualifikuar me arsyetimin se nuk kemi paraqitur Formularin e Sigurimit te Ofertes dhe nuk kemi paraqitur vertetim nga Drejtoria Policise Qarkut Durres per shlyerjen e detyrimeve financiare per vitin 2016.*

*1. Se pari kemi paraqitur ankesen tone per skualifikimin e ofertes se nuk kemi paraqitur Formularin e sigurimit te Ofertes pasi ne DST eshte e parashikuar qarte rastet kur duhet te paraqitet Formulari i Sigurimit te Ofertes:*

*“3.2 Sigurimi i Ofertes: ( i zbatueshem ne rastin e procedurave te prokurimit me vlere me te larte se kufiri i larte monetar, ne rast se kerkohet nga autoriteti kontraktor). Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit te ofertes, kur kerkohet, sipas Shtojces 3. Vlera e kerkuar e sigurimit te ofertes eshte \_\_\_\_\_ Leke (shuma e shprehur ne fjale”.*

*Pra eshte e qarte se ky tender nuk eshte mbi kufirin e larte monetar, edhe nuk eshte kerkuar nga autoriteti kontraktor vlera e sigurimit te ofertes.*

2. *Se dyti kemi paraqitur ankesen tone per skualifimin e ofertes se nuk kemi paraqitur vertetim nga Drejtoria Policise Qarkut Durres per shlyerjen e detyrimeve financiare per vitin 2016.*

*Tek Dokumentet Teknike, konkretisht Vertetimi i Drejtorise Policise Qarkut Durres faqja 29 pika 5 eshte e vertetuar qarte se:*

*“Gjate periudhes se ushtrimit te aktivitetit te ruatjes dhe sigurise fizike nuk jane konstatuar problematika gjate kesaj periudhe. Ka shlyer te gjitha detyrimet financiare per periudhen per vitin 2016”.*

*Eshte e qarte shkelja e procedurave nga KVO ne vleresimin e dokumentacionit te paraqitur ne tender. Kerkojme nga Autoriteti Kontraktor rivleresimin e ofertes se shoqerise NSS Ndreu Security Services dhe kualifikimin e saj si oferte e rregullt dhe qe ploteson te gjitha kerkesat per kualifikim”.*

II.6. Në datën 27.06.2017, me shkresën nr. 1352/2 prot, operatori ekonomik ankimues “NSS” shpk është vënë në dijeni në me pranimin pjesërisht të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor dhe më konkretisht të pretendimit të parë të tij, që lidhet me sigurimin e ofertës.

II.7. Në datën 03.07.2017 operatori ekonomik ankimues “NSS” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor, duke përmendur gjithashtu faktin e pranimit pjesërisht të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor dhe më konkretisht të pretendimit të parë të tij, që lidhet me sigurimin e ofertës.

### Public Health Sector

II.8. Në datë 10.08.2017, Komisioni i Prokurimit Publik, me anë të vendimit K.P.P.605/2017 ka vendosur:

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NSS” shpk për procedurën e prokurimit "Procedure e Hapur " me Nr. REF-06027 -04- 13-2017 me objekt: "Blerje e shërbimit privat të ruajtjes fizike për Spitalin Rajonal Durrës" , me fond limit 10.006.073 leke pa tvsh, e zhvilluar në datën 19.05.2017, nga autoriteti kontraktor , Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.*

2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “NSS” shpk duke e kualifikuar këtë operator.*

3. *Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera, në përputhje me parashikimet e Vendimit nr.482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017”.*

4. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.*

5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomike "NSS" shpk.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë".

II.9. Në datë 23.08.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit, bazuar në vendimin e KPP 605/2017, datë 10.08.2017 - duke kualifikuar operatorin ekonomik "NSS" shpk; si dhe të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave - duke kualifikuar operatorët ekonomikë "Eurogjici Security" shpk dhe "Toni Security" shpk, si më poshtë vijon:

- Kushtrimi 2002	nuk ka paraqitur ofertë	
- Eurogjici Security	8.634.436,66 lekë	I kualifikuar
- Hoxha Security	9156584,00 lekë	I skualifikuar
- Vrana Security Group	9165782,82 lekë	I skualifikuar
- NSS	9168863,99 lekë	I kualifikuar
- Nazeri 2000	9999031,68 lekë	I skualifikuar
- Toni Security	10002392,73 lekë	I kualifikuar

II.10. Në datën 24.08.2017 operatori ekonomik "NSS" shpk., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorëve ekonomikë "Eurogjici Security" shpk dhe "Toni Security" shpk. Konkretisht ankimesi në ankesën e tij pretendon si më poshtë:

### Public Health Sector

*"Ne datën 16.06.2017, përmes faqes së APP jemi informuar për publikimin e renditjes së Ofertave të Procedurës së Prokurimit "Procedure e Hapur", me objekt "Blerje e shërbimit privat të ruajtjes fizike për Spitalin Rajonal Durres", me Autoritet Kontraktor "Spitalin Rajonal Durres", me fond limit 10.006.073 (dhjetë milion e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e tre) leke pa TVSH.*

*Shoqëria NSS Ndreu Security Services Shpk është një shoqëri që ushtron aktivitet në fushën e shoqërive private të sigurisë fizike dhe si e tillë ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit të mesipërme.*

*Nga renditja e ofertave të Operatoreve Ekonomike publikuar në faqen e APP dt.16.06.2017 vihet re se oferta jone është skualifikuar me arsyetimin se nuk kemi paraqitur Formularin e Sigurimit të Ofertes dhe nuk kemi paraqitur vertetim nga Drejtoria Policisë Qarkut Durres për shlyerjen e detyrimeve financiare për vitin 2016*

*Se pari kemi paraqitur ankesën tonë për skualifikimin e ofertes se nuk kemi paraqitur Formularin e Sigurimit të Ofertes pasi në DST është e parashikuar qarte rastet kur duhet të*

*paraqitet Formulari i Sigurimit te Ofertes. Pra ky tender nuk eshte mbi kufirin e larte monetar , edhe nuk eshte kerkuar nga autoriteti kontraktor vlera e sigurimit te ofertes. Kjo pike ankese eshte pranuar nga AK ne pergjigjen e saj nr 1352/3 dt.27.06.2017.*

*Se dyti kemi paraqitur ankesen tone per skualifikimin e ofertes se nuk kemi paraqitur vertetim nga Drejtoria Policise Qarkut Durres per shlyerjen e detyrimeve financiare per vitin 2016. Tek Dokumentet Teknike , konkretisht Vertetimi i Drejtorise Policise Qarkut Durres faqja 29 pika 5 eshte e vertetuar shlyerja e detyrimeve per vitin 2016.*

*Kjo pike ankese nuk eshte pranuar nga AK ne pergjigjen e saj nr 1352/3 dt.27.06.2017*

*Ne daten 03.07.2017 kemi paraqitur ankesen tone prane KPP.*

*Ne date 10.08.2017 KPP ka dale me vendim nr 605/2017 ku i jep te drejte operatorit ekonomik NSS ne ankesen e tij dhe urdheron Autoritetin Kontraktor te anuloje vendimin e KVO mbi skualifikimin e operatorit ekonomik NSS duke e kualifikuar.*

*Ne daten 23.08.2017 Autoriteti Kontraktor ka bere rivlersim te ofertave ku pervec ofertes se operatorit NSS ka kualifikuar dhe Ofertat e shoqerise Eurogjici dhe Toni Security.*

*Me dt.24.08.2017 kemi paraqitur ankesen tone me nr. prot. 1683 ku kemi kerkuar te anulroje menjehere kete rivleresim dhe te skualifikoje ofertat e kualifikuara te Eurogjicit dhe Toni Security te cilat jane ne shkelje te procedurave te prokurimit publik, si dhe te kualifikohet vetem oferta e operatorit NSS ne zbatim te vendimit nr 605/2017, dt.10.08.2017 pasi kjo eshte shkelje e hapur e procedurave nga ana e Autoritetit Kontraktor sepse shoqerite “Eurogjici Security” shpk dhe “Toni Security” shpk kane gene te skualifikuara ne Sistemin e APP dhe nuk kane bere ankimim ne KPP.*

*Me dt.28.08.2017 ne kthimin e pergjigjes me nr. prot.1683/6, Autoriteti Kontraktor pretendon se ankesat e dt.19.06.2017 te operatoreve ekonomike “Eurogjici Security” shpk dhe “Toni Security” shpk jane pranuar; keto te vertetuara me kthim pergjigjet e dt.27.06.2017 , dhe si rrjedhoje duke mos pasur kohe per te bere rivleresimin ne kohe , edhe per shkak te hyrjes se fuqi te VKM m 482 dt.05.07.217 per pezullimin e te gjitha procedurave te tenderimeve publike, si dhe per shkak te pezullimit nga KPP ka pritur vendimin e KPP dhe pastaj ka bere rivleresimin per NSS , dhe per Eurogjicin dhe Toni.*

*Ne si shoqeri pjesemarrrese ne tenderim dhe fituese te procedures ne zbatim te vendimit te KPP nr 605/2017 dt10.08.2017 ngrejme dyshimet tona te bazuara ne fakte se Autoriteti Kontraktor ne bashkepunim me palet e interesuara,ka fallsifikuar dokumentat dhe manipuluar te gjitha proceduren e tenderimit me qellimin per te favorizuar shoqerine Eurogjici , duke u bazuar ne faktet e meposhtme :*

*1. Ne vleresimin e pare te dt.16.06.2017, ne dijenine tone KVO i ka skualifikuar te gjitha ofertat pjese marrese per te njejtat arsye, konkretisht 2 arsye.*



- 1 per mungese te Sigurimit Ofertes
- 2 per mos Shlyerjen e Detyrimeve te Policise per Vitin 2016.

Per kete pike ne do kerkojme nga APP verifikim ne Sistemin Elektronik te Prokurimeve Publike te vleresimit te dt.16.06.2017 per te verifikuar arsyet e skualifikimit per te giithe operatoret.

2. Ne kthimin e pergjigjes derguar te gjitha shoqerive qe jane ankuar eshte pranuar pika e pare e ankeses per Sigurimin e Ofertes dhe eshte refuzuar pika e dyte e ankeses per Shlyerjen e Detyrimeve te Policise per Vitin 2016. Ne kthimin e pergjigjes, pretenduar se i eshte derguar shoqerise Eurogjici , e derguar me email nga zyra Juridike e shoqerise Eurogjici drejt Administratorit te shoqerise NSS , Autoriteti Kontraktor pretendon se shoqeria Eurogjici ka qene e skualifikuar vetem per sigurimin e ofertes, prandaj eshte pranuar ankesa dhe eshte kualifikuar. Por po ta lexojme me vemendje formati i kthimit te pergjigjes eshte i njejte per te giithe shoqerite, pasi shkruhet qarte qe :

"Nje nga pikat qe operatori ekonomik eshte skualifikuar nga KVO eshte mosparaqitja e sigurimit ofertes" .

Pastaj ne fund te faqes pas argumentimit te Autoritetit Kontraktor shkruhet qarte:

"Ankesa e Operatorit per piken e pare merret parasysht"

Ky eshte fakt i qarte i fallsifikimit te kthimit te pergjigjes pasi formati i kthimit te pergjigjes derguar te giithe operatoreve vazhdon me faqen e dyte ku jepen argumentat se pse nuk pranohet ankesa per piken e dyte Shlyerjen e Detyrimeve te Policise per Vitin 2016

Ky fallsifikim eshte bere i qellimshem per kualifikuar shoqerine Eurogjici dhe per te shpallate fituese te procedures .

3. Gjithashtu ne kthimin e pergjigjes dt.28.08.2017 nr prot 1683/6 Autoriteti Kontraktor pretendon se pasi i ka kthyer pergjigje operatoreve ekonomik per ankesat e tyre me dt.27.06.2017 ka nxjerre nje urdher me dt.04.07.2017 per grupin e rivleresimit te ofertave i cili me dt 07.07.2017 duhet te pasqyronte vleresimin elektronikisht, pasi ka respektuar afatin 10 dite te ankimit ne KPP, gje te cilen nuke realizoi dot per shkak se me dt.05.07.2017 doli VKM nr 482 per pezullimin e te gjitha proceduarave.

Ky eshte nje justifikim i qellimshem dhe i pa pazuar ne asnje ligj e rregullore te procedurave te prokurimeve publike dhe eshte ne mbrojtje te fallsifikimit te dokumentave dhe te gjitha procedures per arsyet e me poshte :

Pas kthimit te pergjigjes operatoreve ekonomike me dt.27.06.2017 per ankesat e tyre, meqe pretendohet se shoqerive Eurogjici dhe Toni u jane pranuar ankesat , Autoriteti Kontraktor ka patur kohen e mjaftueshme ne dispozicion dhe duhet te ishte bere direkt pasqyrimi i ketij rivleresimi ne Sistemin Elektronik ne faqen e APP, pavaresisht afateve te ankimit 10 dite. Ne kete rast behet rivleresimi , priten 10 dite afatet e ankimit dhe nese nuk ka ankesa ne KPP behet direkt njoftimi i fituesit te procedures. Rivleresimi ne sistemin elektronik behet direkt nga KVO brenda dites ose ditën e nesërme pas vendimit per rivleresim te ofertave meqe pretendohet se eshte pranuar ankesa shoqerive Eurogjici dhe Toni, dhe nuk ka asnje arsye e

as baze ligjore, qe pikerisht me dt.04.07.2017, 8 dite pas kthimit te pergjigjeve te ankesave, dhe 1 dite pas ankeses se NSS ne KPP me dt.03.07.2017, te ngrihet grup i rivleresimit te procedures qe te pasqyronte rivleresimin ne sistemin elektronik. Grup rivleresimi ngrihet per shqyrtimin e ankesave dhe rivleresimin e ben KVO ne sistemin e APP direkt me pranimin e ankeses se nje operatori ekonomik. Fakti qe nuk ka pse nje rivleresim ne sistem dmth qe nuk ka patur nje pranim ankeses te plote per shoqerite Eurogjici dhe Toni, pranimi ankeses ka qene i pjesshem vetem per piken e pare dhe jo per piken e dyte. Ne kemi dyshimet tona se Kthimi Pergjigjes dt.27.06.2017 drejtuar shoqerise Eurogjici eshte fallsifikuar dhe manipuluar ne protokoll ne bashkepunim me palet e interesuara pasi eshte e dukshme edhe Vula e Autoritetit Kontraktor ne pergjigjen e manipuluar ndaj shoqerise Eurogjici e cila eshte 0.5 cm me e vogel se Vula origjinale e Autoritetit Kontraktor qe kemi ne shoqeria NSS ne kthim pergjigjen tone .

Gjithashtu pretendimi se VKM nr 482 dt.05.07.2017 eshte bere pengese per rivleresimin ne sistemin elektronik eshte nje justifikim i pa bazuar ne asnje fakt dhe tregon qarte se kjo procedure eshte e manipuluar dhe fallsifikuar ne te gjitha dokumentat dhe shkresat perkatese pikerisht pas dt.03.07.2017 , date kur shoqeria NSS ka depozituar ankesen ne KPP , gje qe ka bere qe Autoriteti Kontraktor dhe shoqerine Eurogjici te kuptoje se shoqeria NSS mund te shpallet fituese me te drejte nga KPP .

Vete fakti qe , shoqeria Eurogjici nuk ka bere asnje ankesa as ne Autoritet dhe as ne KPP per mos rivleresim te ofertes se saj ne kohen e duhur, meqe pretendohet se ju eshte pranur ankesa nga Autoriteti Kontraktor, le te kuptohet qarte se ky manipulim dhe fallsifikim eshte bere pasi jane njoftuar per ankesen e shoqerise NSS ne KPP ne dt.03.07.2017.

4 . Gjithashtu ne pretendimet e saj Autoriteti Kontraktor thote se ka informuar KPP per kete problem ne shkresat e saj nr.1492 dt.12.07.2017 dhe nr. 1598 dt.01.08.2017. Ky eshte nje justifikim pa baze ligjore pasi keto shkresa jane derguar pas dt.03.07.2017 kur shoqeria NSS ka bere ankesa ne KPP dhe pas dt.05.07.2017 kur KPP ka nxjerr urdher pezullimin per proceduren dhe ka urdheruar ti vihet ne dispozicion dosja e procedures.

5. Ne vendimin e saj nr.605/2017 date 10.08.2017 KPP eshte shprehur qarte qe te kualifikohet oferta e shoqerise NSS dhe nuk eshte shprehur fare per kualifikim ose rivleresim te ofertave te shoqerive Eurogjici dhe Toni. Pra eshte e qarte se KPP nuk merr persiper te korrigoje proceduren e nje Autoriteti Kontraktor por duke qene nje institucion qe merr ne shqyrtim ankesat e operatoreve, del me vendim mbi baze te ankesave te protokolluara nga operatoret ekonomike dhe jo mbi haze te deshirave personale te Autoriteteve Kontraktore.

Per sa me siper kerkojme:

- Pranimin e Ankimit
- Skualifikim te Ofertave te shoqerise “Eurogjici Security” shpk dhe “Toni Security” shpk”.

II.11. Në datën 28.08.2017, me shkresën nr.prot.1683/6, operatori ekonomik ankimues “NSS” shpk është vënë në dijeni me mospranimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, si më poshtë vijon:



*“Referuar ankeses tuaj te dorezuar prane Spitalit Rajonal Durres me shkrese nr.1683 prot date 24.08.2017 per proceduren "Procedure e Hapur"me objekt "Blerje e sherbimit privat te ruajtjes fizike per Spitalin Rajonal Durres", me fond limit 10.006.073 (dhjete milion e gjashte mije e shtatedhjet e tre) leke ju bejme me dije se:*

*Mbas shqyrtimit te dokumentacionit qe Sektori perkates disponon mbi kete procedure rezulton se prane autoritetit kontraktor jane paraqitur nje Formular Ankese nga operatori “Toni Security” shpk, me nr.1339 prot. date 19/06/2017; nje Formular Ankese nga operatori nga “Eurogjici Security” shpk, me nr.1340 prot. date 19/06/2017; nje Formular Ankese nga operatori “NSS- Ndreu” shpk, me nr.1352 prot. date 20/06/2017; si dhe nje Formular Ankese nga “Vrana Security” shpk, me nr.1368 prot, date 22/06/2017.*

*Ankesat pasi jane shqyrtuar nga Komisioni i Posacem i shqyrtimit ngritur me nr. 1352/1 prot, date 20/06/2017 dhe urdher nr.1368/1 prot. date 23/06/2017, rezulton se jane refuzuar ankesat e OE Vrana Security dhe NSS Ndreu Security Services. Nderkohe qe ankesat e OE Eurogjici dhe Tony Security jane pranuar .*

*Kthim pergjigjet me nr.1339/4 prot. date 27/06/2017, nr.1340/3 prot. date 27/06/2017 , nr. 1368/3 prot. date 27/06/2017 dhe nr.1352/3 prot. date 27/06/2017 i jane derguar operatoreve ekonomik me shkrim (poste) dhe nepermjet e-mailit.*

*Me date 04/07/2017 eshte ngritur me urdher te brendshem grupi i rivleresimit te procedures i cili me date 07/07/2017 duhej te pasqyronte vleresimin elektronikisht (eshte respektuar e drejta e ankimimit ne KPP brenda 10 diteve nga marrja e pergjigjes se ankeses, neni 63 pika 6 LPP) , gje te cilen nuk e realizoi pasi hyri ne fuqi VKM nr.482 date 05/07/2017 per pezullimin e procedurave te prokurimit. Gjithashtu me date 07/07/2017 eshte paraqitur ne SRD vendimi i KPP nr.1199/1 date 05/07/2017 qe urdheron pezullimin e procedures por qe tashme procedura ishte e pezulluar per efekt te VKM nr.482 date 05/07/2017 .*

*Me ane te shkreses nr.1774/1 prot. date 17/07/2017 Kryeministria lejon SRD te beje cpezullimin e procedurave te prokurimit, por perseri KVO e ka te pamundur te reflekoje ne sistem ndryshimet e dates 27/07/2017 pasi procedura vazhdon te jete e pezulluar per efekt te vendimit te KPP-se nr.1199/1 date 05/07/2017.*

*Theksojme se, autoriteti kontraktore, me shkrese nr.1598 prot. date 01/08/2017 ka informuar KPP per te gjitha sqarimet e siperpermendura.*

*Komisioni i Rivleresimit me date 23/08/2017 ne zbatim te Vendimit te KPP 605/2017 date 10/08/2017 ben rivleresimin ne sistem duke kualifikuar “NSS Ndreu Security Services” shpk nga njera ane dhe nga ana tjeter kualifikon OE Eurogjici dhe Tony Security, ankesat e te cileve jane shqyrtuar nga komisioni i posacem per shqyrtimin e ankesave ne zbatim te LPP dhe jane pranuar.*

*Per sa me siper ankesa juaj per skualifikimin e operatoreve te tjere Eurogjici dhe Tony Security nuk qendron.”*

II.12. Në datën 04.09.2017 operatori ekonomik ankimues “NSS” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

II.13. Nëpërmjet shkresës me nr.1722/3 prot, datë 08.09.2017, protokolluar me tonën me nr.prot. 1431/2, datë 11.09.2017 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NSS” sh.p.k mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” dhe “Toni Security” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 14.04.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit "Procedure e Hapur " me Nr. REF-06027-04-13-2017 me objekt: "Blerje e shërbimit privat të ruajtjes fizike për Spitalin Rajonal Durrës" , me fond limit 10.006.073 leke pa tvsh, e zhvilluar në datën 19.05.2017, nga autoriteti kontraktor , Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.

III.1.2. Në datën 19.05.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

III.1.3. Në datën 16.06.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Kushtrimi 2002	nuk ka paraqitur ofertë	
- Eurogjici Security	8.634.436,66 lekë	I skualifikuar
- Hoxha Security	9156584,00 lekë	I skualifikuar
- Vrana Security Group	9165782,82 lekë	I skualifikuar
- NSS	9168863,99 lekë	I skualifikuar
- Nazeri 2000	9999031,68 lekë	I skualifikuar
- Toni Security	10002392,73 lekë	I skualifikuar

III.1.4. Në datë 10.08.2017, Komisioni i Prokurimit Publik, pas ankimit të operatorit ekonomik “NSS” shpk që kundërshton skualifikimin e tij, me anë të vendimit K.P.P.605/2017 ka vendosur:

“1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NSS” shpk për procedurën e prokurimit "Procedure e Hapur " me Nr. REF-06027 -04- 13-2017 me objekt: "Blerje e

shërbimit privat të ruajtjes fizike për Spitalin Rajonal Durrës", me fond limit 10.006.073 leke pa tvsh, e zhvilluar në datën 19.05.2017, nga autoriteti kontraktor , Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik "NSS" shpk duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera, në përputhje me parashikimet e Vendimit nr.482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave "Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017".
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomike "NSS" shpk.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë".

III.1.5. Në datë 23.08.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit, i cili është kryer përkatësisht (siç dhe është specifikuar në SPE); bazuar në vendimin e KPP 605/2017, datë 10.08.2017 - duke kualifikuar operatorin ekonomik "NSS" shpk; si dhe të Komisionit të shqyrtimit të Ankesave - duke kualifikuar operatorët ekonomikë "Eurogjici Security" shpk dhe "Toni Security" shpk, si më poshtë vijon:

- Kushtrimi 2002	nuk ka paraqitur ofertë	
- Eurogjici Security	8.634.436,66 lekë	I kualifikuar
- Hoxha Security	9156584,00 lekë	I skualifikuar
- Vrana Security Group	9165782,82 lekë	I skualifikuar
- NSS	9168863,99 lekë	I kualifikuar
- Nazeri 2000	9999031,68 lekë	I skualifikuar
- Toni Security	10002392,73 lekë	I kualifikuar

III.1.6. Referuar VKM nr. 184, datë 17.03.2010, "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimesit dhe respektimit afateve), edhe "elementet e domosdoshëm të ankesës, sipas përcaktimeve të nenit 17, "Forma dhe përmbajtja e ankesës", pika 3: "Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;"

Ndërsa në nenin 27 "Kufijtë e shqyrtimit të ankesës" të VKM nr. 184, datë 17.03.2010, "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar, thuhet: " [...]. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës

*dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre [...]”.*

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer në sistemin e prokurimeve elektronike (S.P.E.), fillimisht procesin e vlerësimit më datë 16.06.2017 dhe më pas atë të rivlerësimit më datë 23.08.2017. Në rivlerësimin e kryer nga AK, referuar gjithashtu edhe dokumentacionit të dorëzuar nga AK, rezulton se në sistemin e prokurimeve elektronike janë reflektuar njëkohësisht si konstatimet e vendimit të KPP 605/2017, datë 10.08.2017 - duke kualifikuar operatorin ekonomik “NSS” shpk; gjithashtu dhe vendimi i Komisionit të shqyrtimit të Ankesave - duke kualifikuar operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” shpk dhe “Toni Security” shpk.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se operatori ekonomik ankimues “NSS” shpk në ankesën drejtuar KPP, nuk ngre pretendime në lidhje me plotësimin e dokumentacionit në plotësim të kriterëve të dokumentave standarde të tenderit të vendosura nga AK, por ngre pretendime *a-priori* për operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar. KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tyre, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ankesa.

Në vijim, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se shqyrtimi i pretendimeve të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “NSS” shpk se “*Autoriteti Kontraktor ne bashkepunim me palet e interesuara, ka fallsifikuar dokumentat dhe manipuluar te gjithe proceduren e tenderimit me qellimin per te favorizuar shoqerine Eurogjici*”, është përtej kompetencës lëndore të këtij të fundit, referuar edhe nenit 19/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar ku parashikohet se “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj”. Në këto kushte, referuar materialeve të administruara në fashikullin e gjykimit - dhe duke qenë se vetë operatori ekonomik ankimues “NSS” shpk, në ankimin e tij drejtuar KPP thekson se do t’i drejtohet Agjencisë së Prokurimit Publik-; Komisioni i Prokurimit Publik në zbatim të nenit 13 të lex specialis i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet e mësipërme.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik “NSS” shpk për procedurën e prokurimit "*Procedure e Hapur* " me Nr. REF-06027 -04- 13-2017 me objekt: "Blerje e shërbimit privat të ruajtjes fizike për Spitalin Rajonal

- Durrës", me fond limit 10.006.073 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 19.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të vazhdojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit në përputhje me parashikimet e Vendimit nr.482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave "Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017".
  3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
  4. T'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ nr.1431 prot, datë 04.09.2017.
  5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "NSS" shpk.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.1431 Protokoli, Datë 04.09.2017**

